

# STATUT

DHE

## AKT - THEMELIMI

I

**SHOQËRISE TREGËTARE "E.A.K-energy" sh.p.k.**

### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Sipas kërkesave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit", krijohet shoqëria tregtare "**E.A.K-energy**" sh.p.k. e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, nenet e këtij statuti si dhe aktit bashkëngjitur tij.

### KREU II

#### EMRI, STATUTI, SELIA, KOHËZGJATJA

#### NENI 1

**Sot me date 26.06.2018** formohet shoqëria tregtare e emërtuar "**E.A.K-energy**" sh.p.k. me themelues:

- 1- "**LUFI-TRANG**" sh.p.k me nipt **K88521301T** ,me adrese Lezhe,Mamurras,Lagjja Drita, Qender Mamurras, Pallati i ri me nr. pasurie 1/1115-N6, Z.Kadastrale Nr.2586, Mamurras Kurbin,Kati 1 perfaqesuar nga **Z.Ardjan GJINAJ** i biri i Bibe dhe i Dilë , i datëlindjes 24.02.1972, lindur në Bushnesh Kruje dhe banues në Mamurras Kurbin.



- 2- Znj. Renata GJINAJ e bija e Dod dhe e Pashke, e datëlindjes 17.08.1996, lindur në Tiranë me nr. personal letërnjoftimi karte identiteti 32489134 dhe banues në Fushe Mamurras, Kurbin;
- 3- Z. Julian Përgega i biri i Gjin dhe i Liza, i datëlindjes 14.09.1974, lindur në Rreshen Mirdite me nr. personal letërnjoftimi karte identiteti 029209819 dhe banues në Rreshen.

#### NENI 2

Emri i shoqërisë do të jetë nga "E.A.K-energy" sh.p.k.

#### NENI 3

Shoqëria do të ketë statusin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.

#### NENI 4

Selia e shoqërisë tregtare private "E.A.K-energy" sh.p.k., do të jetë në adresën **Lezhe, Mamurras, Lagjja Drita, Qender Mamurras, Pallati i ri me nr. pasurie 1/1115-N6, Z.Kadastrale Nr.2586, Mamurras Kurbin, Kati 1;**

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

#### NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat mbi 10 vjet.

#### NENI 6

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "E.A.K-energy" sh.p.k., niptin e shoqërisë, Tiranë, Albania

#### KREU III



## OBJEKTI

### NENI 7

#### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Prodhim I energjise elektrike nga burimet e rinovueshme .Ndertimi I hidrocentraleve ,termocentraleve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme.Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit.Transmetimi I energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte ,funksion I cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar.Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh transformuese per transmetimin e energjise elektrike. Operator I sistemit te transmetimit dhe te dispecerimit 2(axhustim ose rregullim I prodhimit te energjise elektrike ne nivel kombetar. Shperndarjen ,transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit te mesem dhe te ulet,duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori I fundit.Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri,firma,agjensi dhe ndermarrje te tjera ,te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti.Ndertim dhe shitblerje, apartamentesh ,zyrash godinash si dhe kryerjen e cdo lloj aktiviteti tregtar, industrial,financiar me prona te tundshme dhe te patundshme, Import-Eksport. Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe /ose pjesmarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri ne baze te legjislacionit shqiptar.

## KAPITALI

### NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërise është 300.000 lekë dhe zotërohet si më poshtë:

- 1- **“LUFITRANG” sh.p.k me nipt K88521301T** ,me adrese Lezhe,Mamurras,Lagjja Drita, Qender Mamurras, Pallati i ri me nr. pasurie 1/1115-N6, Z.Kadastrale Nr.2586, Mamurras Kurbin,Kati 1



- 1- 24.02.1972, lindur në Bushnesh Kruje dhe banues në Mamurras Kurbin zoteron 40% te kapitalit **ne vlerë 120.000 leke e ndare në 1 kuote.**
- 2- **Znj.Renata GJINAJ** zotëron 30% te kapitalit **ne vlerë 90.000 lekë e ndarë në 1 kuotë.**
- 3- **Z.Julian Përgega** zotëron 30% te kapitalit **ne vlerë 90.000 lekë e ndarë në 1 kuotë.**

#### **NENI 9**

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

#### **NENI 10**

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakut brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

#### **NENI 11**

Kapitali shoqërisë do të përbëhet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luejtëshme e të paluejtëshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

#### **NENI 12**

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet e lindura më parë ndaj shoqërisë. Gjithashtu ai gëzon të gjitha të drejtat e lindura para largimit të tij.

#### **KREU IV**



## ORGANET DREJTUESE

### NENI 13

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori;
- Administratori i Shoqërise do të jetë **Z. Ardjan GJINAJ** me afat 5-vjet me të drejtë ripërsëritje;

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë:

### NENI 14

**Asambleja e Ortakëve** është organi më i lartë vendimor.

### NENI 15

**Asambleja e ortakëve** vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, shtimin ose pakësimin e kapitalit, për emërimin e organit administrativ, për drejtimit kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

## ORGANI ADMINISTRATIV

### NENI 16

Administrator i shoqërisë "**E.A.K-energy**" sh.p.k. është **Z. Ardjan GJINAJ** i biri i Bibe dhe i Dilë , i datëlindjes 24.02.1972, lindur në Bushnesh Kruje dhe banues në Mamurras Kurbin.

### NENI 17

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 6 të këtij statuti.

Organi Administrativ është kompetent për:

- të realizuar mbledhjen e Asamblesë së ortakëve;



- të miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozon rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit, etj. ;
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në cështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- përfaqësuar shoqërinë në regjistrin e pronës sipas nenit 20 të këtij statuti.

## **KREU V**

### **KUSHTET EKONOMIKE**

#### **NENI 18**

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si cdo person tjetër juridik në Shqipëri, mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

#### **NENI 19**

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë.

#### **NENI 20**

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e regjistrimit në organet tatimore, ndërsa vitet e tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti; Në çdo fund të periudhës ushtrimore hartohet bilanci kontabël sipas ligjeve në fuqi brenda dates 31 Mars të vitit pasardhës nxirret bilanci;



Bilancet periodike (mujore, tremujore dhe gjashtëmujore) miratohen e nënshkruhen nga Administratori e më pas në mbedhjen e radhës së Asamblesë së Ortakëve;  
Bilancet vjetore miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe nënshkruhen nga administratori.

#### **NENI 21**

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria u mbetet në përdorim Ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likujduar të gjitha detyrimet dhe të jete hequr fondi i rezervës ligjore, sipas vendimit të Ortakëve.

#### **NENI 22**

Marëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në R.Sh. Mosmarveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë sic është parashikuar në kontratë.

#### **KREU VI**

#### **NENI 23**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Ortakëve për shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative;
- pamundësi veprimi;
- shpërndahet me vullnetin e ortakëve;
- riorganizohet në një formë tjetër;

#### **NENI 24**





Në kushtet e nenit 23 të këtij statuti Asambleja e Ortakëve cakton një ose më shumë likujdatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer gjithë veprimet e likuidimit të saj, duke likujduar në radhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likuidimit, kjo i shpërndahet ortakëve, ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit ortakët janë të detyruar të derdhin kuotën deri në nivelin e kuotave të kapitalit themeltar.

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **NENI 25**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

#### **NENI 26**

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve që do të bëjnë ortakët si dhe ligjeve të vecanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxiret vetë statuti.

#### **NENI 27**


Ky statut u përpilua në prani të Ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të lirë.

Ai u përpilua në kater kopje me fuqi të barabartë secila për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë, në zyrën e Tatim -Taksave dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.


### **ORTAKËT**

PER SHOQERINE "LUFITRANG" SH.P.K

**Ardjan GJINAJ**



**Renata GJINAJ**



**Julian PËRGEGA**

